



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1045/6 Prot.

Tiranë, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 27, datë 28.03.2023

PËR

**“MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE,  
KËRKIMORE-SHKENCORE, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, TË UNIVERSITETIT  
TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, germa h), Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar të MAS, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 5, datë 10.02.2023, në mbledhjen e datës 28.03.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore, për vitin akademik 2021-2022, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Raporti Vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore, për vitin akademik 2021- 2022 i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të publikohet në faqen zyrtare të UMT- së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të institucionit.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446/9 Prot.

Tiranë, më 02.05.2023

VENDIM

Nr. 37, datë 02.05.2023

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 28.03.2023 “PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE, KËRKIMORE-SHKENCORE, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 112, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, germa h), Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar të MAS, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Vendimit të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 5, datë 10.02.2023, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 28.03.2023 “Për miratimin e raportit vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore, për vitin akademik 2021-2022, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” në titullin e tij, pas shprehjes “kërkimore-shkencore”, shtohet shprehja “dhe financiare”.
2. Në pikat 2 dhe 3 të Vendimit, pas shprehjes “kërkimore-shkencore”, shtohet shprehja “dhe financiare”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të institucionit.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË  
VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ